



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 07. 10. 2008, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

Procesverbal
i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Ramadan Avdiu, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini dhe Radmilla Vujoviq.

Munguan: Enis Kervan, Eqrem Kryeziu dhe Nexhat Daci.

Në mbledhje sipas ftesës ishte i pranishëm ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Skender Hyseni. Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit, me këtë

RENDITE

1. Informatë e ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme z. Skender Hyseni

Sabri Hamiti lidhur me iniciativën serbe të paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për ta referuar çështjen e legalitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, propozoi që Komisioni të nxjerrë një deklaratë për të cilën i ofroi anëtarëve të Komisionit tekstin e Propozimdeklaratës.

Komisioni shqyrtoi tekstin e propozuar dhe pas votimit nxori këtë

DEKLARATË

E Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës në lidhje me iniciativën e paraqitur para Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për ta referuar çështjen e legalitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës te Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Përkujton se Kuvendi i Kosovës e ka shpallur pavarësinë e vendit më 17 shkurt 2008, duke legjitimuar vullnetin e qytetarëve të vet, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, njësi konstituive e së cilës ishte, pas luftës së gjatë politike e të armatosur për liri e çlirim nga okupimi serb;

Përkujton se Serbia bëri luftë agresioni e spastrimi etnik, me elemente gjenocidi, kundër Kosovës dhe popullit të saj, e cila përfundoi me kundërvënien e armatosur të UÇK-së dhe ndërhyrjen vendimtare të forcave të NATO-s, të udhëhequra nga SHBA-ja, në pranverën e vitit 1999;

Përkujton se Kosova ka gëzuar pavarësi faktike nga Serbia që nga qershori i vitit 1999, duke qenë e administruar përkohësisht nga OKB-ja, dhe duke ndërtuar institucionet e veta shtetërore demokratike;

Shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe aprovimi i Kushtetutës së Republikës është bërë me procedura të rregullta e demokratike, duke legalizuar vullnetin e popullit të saj, në pajtim dhe në koordinim me shtetet dhe organizmat ndërkombëtarë të përfshirë në procesin e definimit të statusit të Kosovës, të udhëhequr nga Emisari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisaari;

Republika e Kosovës ka krijuar institucionet dhe legjislacionin e shtetit të pavarur, dhe është njohur deri tani nga 47 shtete, anëtare të OKB-së;

Komisioni për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Rithekson se pavarësia e Kosovës tanimë është realitet i pakthyeshëm, i ndërtuar në përputhje me ligjet ndërkombëtare.

Prandaj, Komisioni u drejtohet anëtarëve të OKB-së pjesëmarrës të Asamblesë së Përgjithshme me kërkesë që iniciativa për referim të çështjes së legalitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, e paraqitur nga Serbia, agresore e Kosovës në të kaluarën e afërt, të trajtohet si përpjekje dhe fushatë për ta penguar zhvillimin e shtetit të ri demokratik të Kosovës, për të penguar njohjen e saj ndërkombëtare të mëtejme, si dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë trupat e OKB-së.

Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës konsideron që trajtimi eventual miratues i iniciativës së Serbisë në OKB nuk do t'i kontribuonte stabilitetit në rajonin e Evropës Juglindore dhe më gjerë.

Deklarata u miratua me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm, nga votimi abstenuan deputetët, Ardian Gjini dhe Radmilla Vujovic.

Sabri Hamiti në vazhdim ia dha fjalën ministrit Skënder Hyseni, që të njoftoj Komisionin mbi zhvillimet diplomatike në OKB dhe qëndrimet e presidentit dhe të ministrit atje.

Skënder Hyseni tha se gjatë qëndrimit në Nju Jork kanë pasur një agjendë marramendëse dhe takime të shumta, ku përqendrimi i tyre ka qenë në përcjelljen e mesazhit në dy fusha, në njohjen e mëtejme të shtetit të Kosovës, dhe me nismën serbe në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, për të kërkuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë një mendim këshillëdhënës dhe të validitetit legal të shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Ai tha se në takimet e shumta që kanë pasur, në rend të parë kanë tërhequr vërejtjen për pasojat që mund të prodhoj kalimi eventual i rezolutës serbe. Kalimi i kësaj rezolute do të ketë efekte anësore negative në procesin e njohjeve të mëtejme të shtetit të pavarur të Kosovës, e që do të hetohet ekskluzivisht te një grup i vogël i vendeve edhe ashtu hezituese .

Në vazhdim tha se ka ndonjë vend aty këtu, që është deklaruar në favor të iniciativës serbe: Afrika e Jugut dhe Egjipti, dhe të dy këto vende i ka takuar në nivel ministrash.

Ministri i Jashtëm i Afrikës së Jugut në mënyrë eksplicite ka deklaruar se nuk e kundërshton pavarësinë e Kosovës, por qëndrimin do ta marrë atëherë kur e sheh të përshtatshme për raportet e brendshme të saja. Ministri i Jashtëm i Egjiptit, ka thënë se takimin e ka mirëpritur dhe e ka caktuar në misionet e përhershme të Egjiptit në OKB, dhe këtë e ka konsideruar si praninë të ministrit të Kosovës në territorin e OKB-së. Egjipti nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, por vendimin do ta marrë pasi që Gjykata Ndërkombëtare do të bëjë vlerësimin, lidhur me iniciativën serbe.

Kalimi i nismës serbe nuk do të prodhoj efekte pozitive as për vetë Serbinë, sepse do të mbetet peng e pritjeve dhe e ngecjeve në shumë procese jetike, por kjo nismë do të ndërlidhet edhe me interesat e Kosovës, sidomos në proceset integruese evropiane dhe të anëtarësimit të Kosovës në organizata tjera ndërkombëtare e rajonale.

Vendet kyçe që e përkrahin Kosovën janë të bindura, se kjo iniciativë nuk do të marrë një numër të madh votash nëse kalon.

Disa shtete të BE-së, si Franca edhe disa shtete të tjera janë duke bërë përpjekje që brenda BE-së, të arrihet konsensus për abstenim, që të mos ketë përçarje të mëdha brenda BE-së rreth votimit, që do thotë se nëse kalon nisma mund të kaloj me një numër të vogël të votave .

Ai në vazhdim tha se në të gjitha takimet që ka pasur është krijuar një përshtypje e saktë se procesi i njohjes nuk do të ndalet.

Në takim me ambasadorin e Portugalisë, ka pasur shenja tepër premtuese për njohjen e pavarësisë së Kosovës, gjithashtu është një përkushtim i fuqishëm që shqyrtimi i njohjes të bëhet nga një numër i vendeve të Konferencës Islamike, siç është Malezija, si dhe nga një numër i madh i vendeve të Amerikës Qendrore.

Iniciativa serbe e ka aktualizuar tani në shumë vende edhe debatin rreth njohjes së Kosovës, debat që ka qenë heshtur në shumë vende.

Qeveria ka një plan se çka duhet bërë nëse nisma serbe kalon dhe janë duke u bërë përgatitjet fillestare gjatë gjithë kohës në mënyrë që pavarësia e Kosovës të mbrohet dhe të argumentohet në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Ai tha se, ka vende të ndryshme të rajonit të cilat shqyrtojnë seriozisht mundësinë e njohjes së Kosovës dhe kjo i është thënë presidentit të Kosovës, në mënyrë eksplicite nga vendet fqinje dhe neve na mbetet të presim që të mbahen premtimet e tyre.

Ka edhe vende të tjera të vogla siç janë Portugalia e Malezia të cilat presin lëvizjen e vendeve më udhëheqëse rajonale, se çështja e njohjes është e përfunduar sa u përket atyre. Kjo e shton nevojën që ne si institucione të përqendrojmë presionin tonë në vendet bosht në rajone të caktuara, siç është Arabia Saudite që ka peshë të madhe në vendet e tjera të vogla.

Po ashtu tha se grupe vendesh të Unionit Afrikan janë duke shikuar mundësinë e përnjëhershme të njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Lutfi Haziri në mes tjerash tha se, aktivizimi i diplomacisë parlamentare si hallkë e punës edhe më tutje po mbetet dobësi.

Në vazhdim ai pyeti, pasi që qeveria e ka një plan të qartë nëse rezoluta serbe kalon, a ka pasur plan të qartë Qeveria për ta parandaluar nismën serbe përveç angazhimit tuaj fizik në takime dhe cili do të ishte plani, hapi kryesor i cili do të determinon reaksionin apo ofensivën e qeverisë.

Skënder Hyseni tha se ne do të angazhohim një trup avokatësh e juristësh me renome ndërkombëtare për ta mbrojtur çështjen në Gjykatën Ndërkombëtare, por ende nuk e kemi finalizuar këtë plan.

Për këtë çështje nuk do të hezitohet as kursehet sepse Kosova ka mjaft argumente dhe jemi duke punuar rreth kësaj çështjeje.

Ardian Gjini tha se nuk është praktikë demokratike që Qeveria të mos e njoftoj Kuvendin lidhur me planin e saj .

Skënder Hyseni tha se plani i Qeverisë është angazhimi i një kompanie të fuqishme, për të cilën janë ende duke u zhvilluar bisedimet dhe ende nuk janë rumbullakuar.

Ministria e Punëve të Jashtme asnjëherë nuk do të hezitojë që të ndajë informacionet me Komisionin për Punë të Jashtme, rreth asnjë zhvillimi që lidhet me politikën e jashtme.

Ibrahim Gashi lidhur me deklaratën e miratuar nga Komisioni tha se është post festum. Tani asnjë diplomat edhe sikur ta lexojë deklaratën nuk e ndërron mendjen e tij sepse është qëndrim i shteteve dhe jo i diplomatëve që do të përfaqësojnë shtetet nesër atje. Në mbledhje të Kryesisë rikujtoi se kjo nismë, është dashur të shkojë më herët, sipas kërkesës së një përfaqësuesi të AKR-së që t'i drejtohem të gjitha vendeve të OKB-së për të drejtën e ligjshme të Kosovës në shpalljen e pavarësisë. Në vazhdim tha se gjatë qëndrimit atje janë parë rezultate konkrete në relacione në mes shteteve, a do të thotë kjo që kontakti fizik është i pazëvendësueshëm, a ka pasur një vonesë në qasje ndaj këtyre instancave si dhe a ka pasur një logjistikë dhe protokoll që e ka mbështetur punën apo janë bërë takimet ad hoc.

Lidhur me konsekuencat nëse kalon nisma serbe, tha se prononcimin e ministrit e ka kuptuar se nuk do të ketë konsekuenca, gjë që mendon ndryshe.

Njëkohësisht pyeti nëse do të kaloj nisma serbe, a keni ndonjë plan lobimi se si t'i qaseni pjesëve të botës që ndoshta janë gatshme për njohje mes periudhës kur kalon nisma serbe dhe kur ajo shqyrtohet, dhe si do t'i qaseni ndonjë regjioni i cili ndoshta më pak do të influencohet nga shkuarja e çështjes në gjykatë.

Skënder Hyseni lidhur me organizimin e agjendës rreth shkuarjes në Nju Jork tha se ajo ka filluar nga 26 korriku, kur edhe i është dërguar nota 57 misioneve me kërkesa për takime.

Protokolli i Kosovës ka qenë si i çdo shteti anëtarë, përveç që nuk ka pasur qasje në sallën ku janë zhvilluar fjalimet e Asamblesë së Përgjithshme.

Delegacionit të Kosovës i janë rezervuar zyrat e improvizuara, si për çdo delegacion tjetër për takime .

Lidhur me takimet ad hoc tha se ka pasur me dhjetëra por ato nuk janë raportuar në cilësi të takimeve.

Nisma serbe tha se do të ndikoj në procesin e njohjes tek ato vende të cilat hezitojnë, dhe tani kanë një pretekst më shumë që ta zvarrisin njohjen.

Ramadan Avdiu tha se duke e pasur parasysh se nisma serbe ka gjasa të kaloj, është mirë që Qeveria e ka planin e veprimit pas kalimit të kësaj nisme. Kjo është një tendencë e Serbisë për bartjen e një veprimi politik në një fushë tjetër juridike dhe nëse do të kalon nisma në Asamblesë të Përgjithshme e OKB-së, kjo nuk duhet të ndikoj në përpjekjet dhe angazhimin e politikës sonë të jashtme për njohje.

Në fund tha se është inkurajuese se shtetet të cilat na kanë njohur, do të vazhdojnë në konsolidimin e zhvillimit të vendit tonë dhe të ndikojnë në vendet e tjera e sidomos në vendet që dikur i kanë pasur koloni.

Lutfi Haziri tha se deklarata e ministrit dhënë këtu lidhur me njohjet, është në kundërshtim me deklaratën e kryeministrit të dhënë ne publik.

Kryeministri para disa ditësh ka thënë se do të ketë njohje befasuese për Serbinë, ndërsa ministri deklaroi se do të ketë njohje por riaktivizimin e tyre e ka bërë iniciativa serbe, këto deklarime kundërshtohen në mes vete.

Skender Hyseni tha se kjo është çështje e mënyrës së artikulimit, por nga vendet fqinje ka pasur njoftime publike për njohje dhe priten njohje .

Ramadan Avdiu kërkoi të informohet nga ministri lidhur me çështjen e të ngarkuarit me punë në Zvicër, se a është kontestuar nga Zvicra apo kanë qenë spekulime mediatike.

Skënder Hyseni tha se, ka vende që e shohin problematike çështjen e dy shtetësisë me rastin e akreditimit të diplomatëve. Në rastin e Zvicrës i vetmi problem është dy shtetësia prandaj, Qeveria Zvicerane kërkon nga ne që të pajtohemi me një nen të Konventës lidhur me përkufizimet e imuniteteve dhe ne jemi në proces të qartësimit të kësaj çështjeje.

Sabri Hamiti e falënderoi ministrin për informatën lidhur me zhvillimet politike që kanë ndodhë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së rreth Kosovës dhe iniciativës për të provuar legalitetin e pavarësisë së Kosovës. Në vazhdim tha se, është nevoja e jashtëzakonshme e aktivizimit të të gjitha instrumenteve institucionale rreth punëve të jashtme që na presin dhe të konkretizohet çka mund të bëj ky Komision në bashkëpunim me MPJ.

Çështja e ngritur nga Serbia edhe pa kaluar por edhe nëse kalon tha se do t'i sjell probleme Kosovës, por duhet të fuqizojmë vullnetin dhe veprimin për të kërkuar dhe gjetur njohje të reja .

Duhet të diferencohet përfundimisht nga kryeministri, nga presidenti nga kryeparlamentari edhe nga ministri vlera e asaj që quhet propagandë dhe e asaj që quhet informatë konkrete.

Kjo kërkesë e Serbisë tha se është instrument për ta ngadalësuar njohjen, që ka për pasojë integrimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe në zhvillimin ekonomik.

Në fund tha se planin të cilin deklaroi Qeveria që do ta bëjnë, patjetër duhet ta paraqesin para këtij Komisioni dhe të koordinohen punët e politikës së jashtme në mes institucioneve përkatëse të parapara me Kushtetutë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30min.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

Përgatitur nga

Njësia për mbështetje të Komisionit